

1 E hënë, 9 tetor 2023

2 [Paraqitja e parë e Ismet Bahtjarit]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 14.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Mirë
7 se vini këtu në këtë sallë gjyqi dhe jashtë saj.

8 Përpara se të fillojmë me vendimin tim për caktimin e
9 datës për këtë Paraqitje të Parë, ishte parashikuar që të
10 bëheshin disa fotografi nga fotografi ynë, po ju si Avokat
11 keni disa rezerva lidhur me klientin tuaj.

12 Z. SYTEMA: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, unë i kam
13 thënë klientit tim që të mos i bëhet fotografi. I nderuar
14 Gjykatës, i kam këshilluar klientit tim që të mos pranojë që
15 të merret fotografia e tij. Ai nuk është një figurë e njohur
16 publike dhe rrezikohet jeta e tij, privatësia e tij, në qoftë
17 se fotografia e tij botohet gjithandej dhe duhet që në këtë
18 çështje të shqyrtojmë privatësinë e tij.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A jeni dakord që të marrim
20 atëherë fotografi për tërë grupin dhe jo klientin tuaj? Pasi
21 është një seancë e cila bëhet publik dhe kemi seancat publike.
22 Prandaj duhet - a mund të bëjmë a është e pranueshme që të
23 bëjmë një fotografi të tërë sallës së gjyqit, por jo klientit
24 tuaj? Dakord?

25 Z. SYTEMA: [Përkthim] Dakord.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'i kërkoj fotografit që
2 të bëjë fotografi të sallës së gjyqit, por jo të zotërisë.
3 Atëherë, keni një minutë e gjysëm në dispozicion.

4 Faleminderit, zonja fotografe, mund të largoheni nga
5 salla e gjyqit.

6 Sekretare, ju lutem, njoftoni numrin e lëndës.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 është çështja KSC-BC-2023-10 Prokurori i Specializuar kundër
9 Sabit Januzit dhe Ismet Bahtjarit

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
11 Sekretare.

12 Përpara se t'ju kërkoj atyre që janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit që të paraqesin veten e tyre, do t'ju kujtoj
14 të tërëve për rregullat që do të ndjekim gjatë të gjithë
15 kohës, me qëllim që kjo procedurë të jetë sa më e mirë që të
16 jetë e mundur.

17 Ju lutem që të flisni në mikrofon. Të ndizni mikrofonin
18 dhe ta fikni sapo të keni përfunduar së folur. Flisni ngadalë
19 dhe qartë pasi kemi përkthim nga gjuha shqipe dhe serbe dhe në
20 gjuhën shqipe dhe serbe, dhe prisni pesë sekonda përpara se të
21 më jepni përgjigje mua apo palëve, dhe pjesëmarrësve me qëllim
22 që t'i lejojnë përthyesit që të përfundojnë përkthimit.

23 Ajo që thuhet në këtë seancë transkriptonet dhe do të
24 paraqitet në transkriptimin që do t'i jepet palëve dhe
25 publikut pas përfundimit të kësaj seance.

1 Do t'u kërkoj palëve po kështu, informatat e kësaj
2 çështje janë të mbrojtura me urdhrat e konfidencialitetit. Në
3 këtë seancë të hapur nuk do të nxirren informata
4 konfidenciale. Në qoftë se ndonjë palë apo pjesëmarrës
5 dëshiron të kalojë në seancë private apo për të përmendur
6 informacionin konfidencial, ju lutem, thoni se përse.

7 Tani do t'i kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
8 paraqesin veten duke filluar me Zyrën e Prokurorit të
9 Specializuar.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në emër të Prokurorisë Josh Everts
11 [sipas përkthimit], Tazneen Shahabuddin, Dirk Jan Laman, John
12 Devaney, dhe pas meje Fabian Unser-Nad

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.
14 Tani pala mbrojtëse.

15 Z. SYTEMA: [Përkthim] Falënderoj Gjykatësin. Unë jam z.
16 Sytema. Jam këtu nga Zyra e Hagës e Avokatëve dhe jam këtu si
17 një Mbrojtës i ditës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.
19 Tani nga Zyra Administrative.

20 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit. Jonas Nilsson
21 zëvendës Administrator. Jam këtu përfaqësues i Zyrës
22 Administrative dhe i stafit të administrimit të gjykatës

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilssen.

24 Dhe e vërej që z. Bahtjari është i pranishëm në sallën e
25 gjyqit.

1 Dhe unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës

2 Paraprake të kësaj çështje.

3 I akuzuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të
4 Specializuara pas konfirmimit të aktakuzës.

5 Z. Bahtjari, ju lutem, ngrihuni në këmbë.

6 Ju lutem, na tregoni emrin tuaj të plotë.

7 I AKUZUARI BAHTJARI: Ismet Bahtjari

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Cila është data e lindjes
9 dhe vendi i lindjes?

10 I AKUZUARI BAHTJARI: 27.02.1963, Fushticë e Poshtme.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Cila është kombësia juaj?

12 I AKUZUARI BAHTJARI: Shqiptar

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Cili është profesioni juaj
14 aktual?

15 I AKUZUARI BAHTJARI: Punoj në ndërtim, profesioni është
16 elektrikist.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari,
18 mund të uleni.

19 Kalojmë tani te historiku procedural i kësaj çështje.

20 Me datën 2 tetor 2023, në cilësinë time, si Gjykatësi i
21 Procedurës Paraprake, kam konfirmuar aktakuzën e paraqitur nga
22 Prokurori i Specializuar kundër z. Bahtjari me të cilin ai
23 akuzohet me: Pika 1, përpjekje për të penguar personat zyrtarë
24 në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë;
25 Pika 2, përpjekje për të penguar personat zyrtarë në kryerjen

1 e kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë pjesë në veprimet e
2 përbashkëta të një grupi; dhe Pika 3, kërcënime gjatë
3 procedura gjatë procedurave gjyqësore.

4 Me datën 5 tetor 2023, ZPS-ja e arrestoi z. Bahtjari në
5 Kosovë dhe në atë pikë atij i është dorëzuar Aktakuza e
6 Konfirmuar. Z. Bahtjari është transferuar në objektin e
7 paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë me datën 6
8 tetor 2023.

9 Z. Bahtjari, përpara se të vazhdojmë më tutje, më duhet
10 të sigurohem që po na ndiqni në një gjuhë të cilën ti e kupton
11 dhe e flet. A mund të konfirmosh që e kuptoni gjuhën shqipe
12 dhe e flisni atë?

13 I AKUZUARI BAHTJARI: Konfirmoj.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari.

15 Tani jam i lumtur që mund t'i ndiqni këto procedura në
16 gjuhën shqipe, gjuhë të cilën e kuptoni dhe e flisni në
17 përputhje me rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe e
18 Provave.

19 Në qoftë se në ndonjë moment nuk na kuptoni apo nuk e
20 dëgjoni përkthimin, ju lutem, më tregoni menjëherë.

21 I AKUZUARI BAHTJARI: Në rregull është, ju tregoj

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Më lejoni tani të shpjegoj se përse bëhet kjo paraqitje e
24 parë, me qëllim që ta kuptojë i akuzuari dhe ato që janë
25 bashkuar neve në galerinë publike dhe që na ndjekin përmes

1 internetit.

2 Seanca e sotme nuk është gjyq. Nuk do të paraqiten prova
3 apo të debatohet mbi prova materiale dhe nuk do të diskutohet
4 apo vendoset lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.
5 Synimi i kësaj paraqitje të parë bëhet sipas nenit 39 të
6 Ligjit dhe rregullës 92 të Rregullores.

7 Në bazë të këtyre dispozitave, unë do të kërkoj që t'i
8 lexohen të akuzuarit akuzat e Aktakuzës, në një gjuhë të cilën
9 ai e kupton dhe e flet; do të konfirmoj që i akuzuari e kupton
10 Aktakuzën; të bindem që të drejtat -- janë respektuar të
11 drejtat e të akuzuarit, në veçanti, e drejta që të ketë
12 mbrojtje ligjore; ta informoj të akuzuarin se brenda 30 ditëve
13 nga dita e seancës së sotme, atij do t'i kërkohet që të
14 pranojë se është i fajshëm ose të deklarojë i pafajshëm për
15 të gjitha pikat e aktakuzës.

16 Në qoftë se i akuzuari dëshiron ta bëjë këtë, ai mund të
17 pranojë menjëherë se është i fajshëm apo të thotë se është i
18 pafajshëm.

19 Dhe së fundmi, unë do të caktoj datat e tjera të
20 përshtatshme për kryerjen e detyrave të mia si Gjykatës i
21 Procedurës Paraprake. Unë pres që palët t'i trajtojnë këto
22 çështje në këtë mënyrë.

23 Në qoftë se ndonjë palë dëshiron të diskutojë ndonjë
24 çështje e cila nuk është e parashikuar në kontekstin e kësaj e
25 seancë paraprake të parë, u kërkohet që ta bëjnë një gjë të

1 tillë me shkrim me anë të një parashtrimi të protokolluar që
2 të më dorëzohet mua.

3 Së pari, z. Bahtjari, a mund t'ju kërkoj që të më
4 konfirmoni që jua kanë dorëzuar Aktakuzën në një gjuhë të
5 cilën ju e kuptoni dhe gjuhë të cilën e flisni?

6 I AKUZUARI BAHTJARI: Po, e konfirmoj

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari.

8 Tani do t'i kërkoj Sekretarisë që të lexojë akuzat e
9 Aktakuzës së Konfirmuar, siç parashikohet nga neni 29 i Ligjit
10 dhe rregulla 2 e Rregullores.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
12 nderuar Gjykatës.

13 Në aktakuzën e konfirmuar Prokurori i Specializuar e
14 akuzon z. Ismet Bahtjari me:

15 Pika 1: Përpyetje për të penguar personat zyrtarë në
16 kryerjen e detyrave përmes kërcënimit të rëndë, i dënueshëm
17 sipas nenit 401(1) dhe (5) të Kodit Kriminal të Kosovës të
18 vitit 2019 dhe nenit 15(2) të Ligjit.

19 Pika 2: Përpyetje për pengimin e personave zyrtarë në
20 kryerjen e detyrave zyrtareve me anë të pjesëmarrjes në
21 veprimin e përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të
22 Ligjit 401(1) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019
23 dhe nenit 15(2) të Ligjit;

24 Dhe Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale, e
25 ndëshkueshme në bazë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës të

1 vitit 2019 dhe nenit 15(2) të Ligjit;

2 2. Këto vepra penale u kryen midis së paku 5 dhe 12
3 prill 2023.

4 3. Në lidhje me këto vepra penale ekziston një dyshim i
5 bazuar mirë se z. Ismet Bahtjari mban përgjegjësi penale sipas
6 nenit 16(3) të Ligjit për:

7 (a) kryerje të veprës penale në pikën 3 në bazë të nenit
8 17 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019;

9 (b) bashkëkryerje me z. Sabit Januzi të veprave penale
10 në pikat 1 deri 3 në bazë të nenit 31 të Kodit Penal të
11 Kosovës të vitit 2019;

12 (c) ndihmë në kryerjen e veprave penale në pikat 1 deri
13 në 3 në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit
14 2019;

15 (d) marrëveshje për të kryer me z. Sabit Januzi veprat
16 penale në pikat 1 deri në 3 në bazë të nenit 35 të Kodit Penal
17 të Kosovës të vitit 2019; dhe/ose

18 (e) tentim për të kryer veprat penale në pikat 1 dhe 2
19 në bazë të nenit 28 të Kodit Penal i Kosovës të vitit 2019.

20 Faleminderit

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

22 Sekretare.

23 Z. Bahtjari, dua t'ju rikujtoj se tani nuk është koha për
24 të kundërshtuar këto akuza, por thjesht për të marrë vesh se
25 ju i keni kuptuar këto. Do të keni mundësi të mjaftueshme për

1 t'i kundërshtuar akuzat me ndihmën e Mbrojtësit tuaj.

2 Z. Bahtjari, a i keni kuptuar akuzat që përmban Aktakuza
3 e Konfirmuar siç i lexoi Sekretaria?

4 I AKUZUARI BAHTJARI: Po.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. Bahtjari mund të uleni.

7 Tani më lejoni t'ju informoj me të drejtat që gëzoni
8 përpara kësaj Gjykate.

9 Ligji i Dhomave të Specializuar dhe rregullat e
10 procedurat ju garantojnë një numër rregullash dhe unë po ju
11 lexoj më të rëndësishmet.

12 E para, është që jeni të i pafajshëm derisa të provohet
13 që jeni fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm. Në përcaktimin
14 akuzave kundër jush, ju keni të drejtë të seancave të drejta
15 dhe publike me përjashtim të masave që merren për mbrojtjen e
16 viktimave dhe të dëshmitarëve.

17 Keni të drejtën që t'ju informojnë menjëherë dhe me
18 hollësi në një gjuhë të cilën e kuptoni lidhur me natyrën dhe
19 arsyet akuzave që janë ngritur kundër jush.

20 Keni të drejtën që të keni kohë të mjaftueshme dhe
21 lehtësirat për të përgatitur Mbrojtjen tuaj dhe për të
22 komunikuar me Mbrojtësin që ju vetë e zgjidhni.

23 Keni të drejtën që Gjyqi të bëhet brenda një periudhe të
24 arsyeshme.

25 Keni të drejtën që gjykimi të bëhet në praninë tuaj dhe

1 të Mbrojtësit tuaj.

2 Keni të drejtën që t'u caktohet një Mbrojtës pa pagesë në
3 qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar për të.

4 Keni të drejti që të pyesni dëshmitarë që vijnë nga ju
5 ose që dikush tjetër t'i pyesë në emër tuaj dhe të kërkonit që
6 të jenë të pranishëm dëshmitarë këtu për t'u marrë në pyetje
7 këtu në emër tuaj.

8 Keni të drejtën që t'ju ndihmojë një përkthyes falas në
9 qoftë se nuk e kuptoni gjuhën që përdoret në Gjykatë.

10 Keni të drejtën që të mos ju detyrojnë të jepni dëshmi
11 kundër vetës tuaj ose të pranoni fajësinë.

12 Keni të drejtën të mbeteni në heshtje dhe nga heshtja nuk
13 del asnjë konkluzion në dënim tuaj.

14 Keni të drejtën po kështu që të bëni deklaratë gojore në
15 rastin tuaj dhe të paraqiteni edhe si dëshmitar nën betim.

16 Keni të drejtën të bëni mocione paraprake për të
17 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për të
18 pretenduar që ka defekte në formën e aktakuzës dhe për të
19 kërkuar që të veprohet aktakuza juaj.

20 Keni të drejtën që brenda 30 ditëve nga dita e sotme t'ju
21 jepen materialet mbështetëse të aktakuzës që është paraqitur
22 për konfirmim.

23 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e
24 dëshmitarëve të cilët dëshiron t'i thërrasë për t'i dhënë
25 dëshmi Prokurorit të Specializuar dhe këtë në gjuhën që e

1 kuptoni, pra në gjuhën shqipe.

2 Keni të drejtën që të merrni menjëherë çdo informatë e
3 cila mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme që ju jeni i
4 pafajshëm apo të ulë shkallën e fajësisë apo mund të ndikojë
5 mbi besueshmërinë, për sa i përket dëshmive të Zyrës së
6 Prokurorit të Specializuar sapo ai ta ketë në dorë këtë
7 informacion, apo nën kontrollin e tij.

8 Keni të drejtën që të gjitha materialet dhe provat
9 relevante apo faktet që i ka Prokurori i Specializuar t'ju
10 dorëzohen juve përpara dhe gjatë procedurës penale. Kjo e
11 drejtë kufizohet vetëm në masën e nevojshme dhe për sa i
12 përket zbatimit të masave balancuese.

13 Keni të drejtën që të mos ju mbajnë të parandaluar për
14 një kohë të paarsyeshme përpara se të hapet çështja.

15 Keni të drejtën të kërkonte rishikimin e vendimeve lidhur
16 me paraburgimin tuaj dhe të apeloni përpara së Gjykatës së
17 Apelit.

18 Ju keni të drejtën t'i drejtoheni me një apel Gjykatës së
19 Apelit, për sa i përket një vendimi lidhur me mocionet
20 paraprake që kundërshtojnë juridiksionin e Dhomave të
21 Specializuara. Keni të drejtën që të kërkonte leje për të
22 apeluar edhe vendimet e tjera.

23 Z. Bahtjari, keni dëgjuar të drejtat më të rëndësishme
24 që ju gëzoni në bazë të kuadrit ligjor të Dhomave të
25 Specializuara të Kosovës.

1 z. Bahtjari, a i kuptoni këto të drejta?

2 I AKUZUARI BAHTJARI: Po, i kuptoj.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari,
4 mund të uleni.

5 Tani dua t'ju informoj se sipas nenit 21(5) të Ligjit, ju
6 nuk mund ta përfaqësoni veten tuaj pasi aktualisht jeni në
7 paraburgim dhe prandaj është i detyrueshëm përfaqësimi nga
8 Mbrojtësi i Specializuar. Si Gjykatës i Procedurës Paraprake
9 unë e kam për detyrë të garantoj që të respektohet e drejta
10 juaj për të patur një Avokat Mbrojtës.

11 Dhe në këtë drejtim, unë kam mbajtur shënim parashtrimin
12 e protokolluar të Administratores që më ka njoftuar mbi
13 caktimin e avokatit të caktuar. Dhe unë e kuptoj nga ky
14 parashtrim se derisa të caktohet Avokati, ju keni z. Hendrik
15 Sytema, si Avokatin Mbrojtës të ditës, në përputhje me
16 seksionin 17(2) të Direktivës mbi Mbrojtësit dhe rregullën 21
17 të Rregullores të Ndhmës Ligjore.

18 Z. Bahtjari, a mund të konfirmoni, që z. Sytema, është i
19 caktuar si avokati juaj Mbrojtës i përkohshëm?

20 I AKUZUARI BAHTJARI: Po

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari,
22 mund të uleni.

23 I akuzuari aktualisht rrjedh që përfaqësohet nga
24 Mbrojtësi i Specializuar.

25 Avokati Mbrojtës, a doni të shtoni ndonjë gjë në emër të

1 të akuzuarit?

2 Z. SYTEMA: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, jo në këtë
3 moment

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Tani do t'i kthehem mundësisë që i akuzuari të deklarohet
6 mbi fajësinë nëse dëshiron në përputhje me rregullën 92.

7 Z. Bahtjari, 30 ditë nga dita e sotme, do t'ju kërkohet
8 që të pranoni që jeni i fajshëm apo të deklaroheni i pafajshëm
9 për secilën prej akuzave të Aktakuzës së Konfirmuar. Në qoftë
10 se dëshironi ta bëni një gjë të tillë, mund të pranoni
11 fajësinë që tani apo të deklaroheni i pafajshëm.

12 Dhe prandaj z. Bahtjari, do t'ju kërkohet, t'ju pyesja
13 nëse keni patur mundësinë t'i diskutoni pikat e Aktakuzës së
14 Konfirmuar me Mbrojtësin tuaj dhe nëse dëshironi që të
15 deklaroheni fajtor apo jofajtor në këtë moment. Në qoftë se
16 po, do t'ju kërkohet që të ngriheshit në këmbë, nëse dëshironi
17 ta bëni këtë deklaratë fajësie, apo jofajësie.

18 I AKUZUARI BAHTJARI: Jo fajësie.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju po deklaroheni se jeni
20 jo fajtor sot, kështu është?

21 I AKUZUARI BAHTJARI: Jo fajtor të gjithë, se jo veç sot

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari.

23 Z. Avokat, ta bëjmë të qartë për transkriptin, që z.
24 Bahtjari sot po deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij
25 dhe deklarohet se është i pafajshëm, a është e saktë kjo?

1 Faleminderit, z. Bahtjari, faleminderit zoti Mbrojtës,
2 mund të uleni.

3 Tani të kalojmë në gjuhët e punës së kësaj procedure. Në
4 këtë datë -- për këtë seancë ne kërkuam lidhur me gjuhën që do
5 të përdoret në bazë të rregullës 8.

6 Palët a mund të na tregojnë praninë e tyre për
7 procesverbalin dhe do t'i kërkoj kësaj.

8 Z. HAFETZ: [Përkthim] Për sa i përket gjuhës, Prokuroria,
9 preferenca jonë do të ishte gjuha angleze.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po e mbajmë shënim.

11 Mbrojtja?

12 Z. SYTEMA: [Përkthim] Edhe ne do të përdorim të njëjtën
13 gjë

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Do të nxjerr një vendim në momentin e duhur. Në urdhrin
16 tim për caktim e kësaj konference të sotme unë thashë që do të
17 caktoja në bazë të rregullës 26, Konferencën e Parë mbi
18 Ecurinë e Çështjes, ditën e enjte, me datë 12 tetor 2023 në
19 orën 2. Synimi i Konferencës për Ecurinë e Çështjes do të jetë
20 për të rishikuar statusin e kësaj çështjeje penale dhe për të
21 organizuar midis palëve, me qëllim që të bëhen përgatitjet e
22 shpejta të duhura për gjykimin.

23 Z. Bahtjari, do t'ju rikujtoj që keni të drejtën që të
24 merrni pjesë në Konferencën për Ecurinë e Çështjes së bashku
25 me Mbrojtësin tuaj. Me gjithë këtë, në qoftë se jepni

1 miratimin me shkrim dhe keni marrë këshilla nga Mbrojtësi
2 juaj, sipas rregullës 26(2) në këtë Konferencë për Ecurinë e
3 Çështjes mund të merrni pjesë ju vetë personalisht, mund të
4 marrë pjesë avokati juaj përmes videokonferencës. Ju Mbrojtësi
5 juaj dhe ju z. Bahtjari të merrni pjesë me videolidhje dhe
6 mund të bëhet në prani - në mungesën tuaj z. Bahtjari dhe
7 Mbrojtësi juaj që merr pjesë me videolidhje.

8 Dhe i kujtoj të gjithëve se në qoftë se Mbrojtësi apo i
9 akuzuari dëshirojnë të marrin pjesë me videolidhje, njoftimi
10 me shkrim do të jepet 24 orë përpara seancës përkatëse me
11 qëllim që Zyra Administrative të ketë kohën për të bërë
12 organizimin logjistik. Këto shënime do të duhet të dorëzohen
13 me email te Zyra Administrative dhe duhet të përfshinë edhe
14 miratimin e shkruar të të akzuarit. Zyra Administrative këto
15 emaile do të duhet t'i dorëzojë dhe të jenë pjesë e procedurës
16 penale.

17 Tani do t'i kërkoj palës Mbrojtëse nëse dëshiron të marrë
18 pjesë në - palës Mbrojtëse nëse dëshiron të marrë pjesë në
19 Konferencën për Ecurinë e Çështjes personalisht apo me
20 videolidhje.

21 Z. SYTEMA: [Përkthim] Do të jem i pranishëm këtu.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Edhe klienti juaj kështu është?

24 Z. SYTEMA: [Përkthim] Po, kështu është.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në qoftë se jo, atëherë do

1 t'ia njoftoni këtë Zyrës Administrative.

2 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror, a keni ndonjë
4 koment për të bërë lidhur me Konferencën për Ecurinë e
5 Çështjes?

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Atëherë do të japim edhe urdhrin me rendin e ditës në
9 kohën e duhur sonte ose nesër. Tani do t'ju kërkoj palëve edhe
10 për mocione paraprake për Konferencën për Ecurinë e Çështjes
11 lidhur me tematikën që do të jetë pjesë e rendit të ditës, dhe
12 unë do të caktoj datën 11 tetor 2023, në drekë si data për
13 dorëzimin e parashtrimeve të protokolluara, të shkruara.

14 Pas Konferencës për Ecurinë e Çështjes do të nxjerr një
15 vendim lidhur me detyrimet që i ka Zyra e Prokurorisë për
16 nxjerrjen e materialeve, në përputhje me rregullën 102 dhe mbi
17 sistemin e redaktimit. Përpara kësaj do të kërkoj parashtrimet
18 nga palët.

19 Unë rekomandoj që palët t'i hedhin një sy vendimit tim
20 kuadër mbi nxjerrjen e materialeve në të gjitha çështjet,
21 përpara se të bëjnë parashtrimet e tyre.

22 Në këtë pikë do t'iu kërkoja palëve nëse kanë ndonjë gjë
23 tjetër që dëshirojnë të ngrenë. Dhe ju kërkoj palëve që të
24 njoftojnë paraprakisht në qoftë se bëhet fjalë për nxjerrjen e
25 materialeve konfidenciale me qëllim që të mund të merren masat

1 e përshtatshme për këtë gjë.

2 Z. Prokuror.

3 Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

5 Avokati Mbrojtës.

6 Z. SYTEMA: [Përkthim] Pala Mbrojtëse nuk ka asgjë për të

7 shtuar në këtë moment.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Dhe së fundmi do të dua t'i kërkoj të akuzuarit nëse ka
10 ndonjë çështje që dëshiron të ngrejë lidhur me arrestimin e
11 tij, me transferimin e tij apo mbajtjen në paraburgim.

12 Z. Bahtjari ju e keni fjalën.

13 I AKUZUARI BAHTJARI: Unë nuk kam kurrëgjja. Avokati i ka
14 këto sende. Unë s'kam send as me shtu as me hek.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Bahtjari.

16 Dhe duke qenë që mbeteni në paraburgim z. Bahtjari dua
17 t'ju informoj se ju mund ta kundërshtoni mbajtjen tuaj në
18 paraburgim, sipas rregullës 57, dhe kjo do të trajtohet përmes
19 vendimeve me shkrim.

20 Këtu përfundon seanca e sotme. Falënderoj palët, Zyrën
21 Administrative për praninë e tyre, përkthyesit, stenografen,
22 teknikët audiovizual.

23 Faleminderit, këtu pezullohet seanca.

24 --- Paraqitja e parë mbaron në orën 14.29

25